PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots + On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet

para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për

Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					

Çmimi total me TVSH:	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të

klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan përfshin 6 (gjashtë) bashki me një shtrirje gjeografike të konsiderueshme dhe gjeneron rreth 67 000 (gjashtëdhjetë e shtatë mijë) fatura për abonentët e saj. Bazuar në Ligjin Nr. 87/2019 "Për faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit" dhe Udhëzimit nr. 16 datë 03. 04. 2020 "Për faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit" dhe Vendimit Nr. 239 datë 20. 03. 2020 "Për Kërkesat teknike dhe funksionale të

zgjidhjes software për procedurën e faturimit dhe të fiskalizimit si dhe procedura për kriteret e regjistrimit e prodhuesve e të mirëmbajtësve të zgjidhjeve software-ike”, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan kërkon mirembajtje dhe permiresime per sistemin e faturimit dhe fiskalizimi i faturave.

Baza e të dhënave e sistemit gjate gjithë procesit te mirembajtjes duhet të jetë e optimizuar që të përballojë sasinë e faturave aktuale te cilat do të fiskalizohen në të njëjtën kohë çdo muaj, rritjen e vazhdueshme të numrit të faturave dhe veprimeve që do të kryejnë përdoruesit në sistem, gjenerimin e raporteve kurdo që t’i duhet përdoruesve të SHRUK Elbasan. Baza e të dhënave duhet të jetë e pa aksesueshme nga përdorues të tjerë, përveç specialistëve të operatorit ekonomik për nevoja të mirëmbajtjes. Të dhënat në bazën e të dhënave nuk duhet të modifikohen në ndërhyrje të drejtpërdrejt në bazën e të dhënave, per asnje arsye qofte, duke mos anashkaluar ndërfaqen e programit i cili ruan dhe log files. Operatori ekonomik në mënyrë të vazhdueshme duhet të kujdeset që baza e të dhënave të jetë e optimizuar për të dhënë performancë maksimale.

Operatori ekonomik duhet të ndjekë procese pune të mirë-planifikuara gjatë zbatimit të kontratës, sipas udhëzimeve të standardeve ndërkombëtare të menaxhimit të projekteve. Në mendimin tonë, metodologjia agile ose ekuivalente e saj, do të ishte më efikase e cila ndihmon në lëvrimin e projekteve në një shtrirje kohore të shkurtër dhe ofron *feedback* për të gjithë palët e përfshirë në projekt duke mundësuar të ndërhyhet në kohë nëse ndonjë prej proceseve nuk jep rezultatin e pritur. Operatori ekonomik do të ketë në dispozicion specialistët e SHRUK Elbasan që ata të japin informacionin e duhur. OE duhet t’i bëjë të ditur planin e saktë të punës specialistëve të SHRUK Elbasan duke i qartësuar momentet kur ata do të jenë të domosdoshëm dhe çfarë kontributi pritët prej tyre që në nisjen e zbatimit të kontratës dhe gjatë të gjithë fazave të zbatimit të saj deri në dorëzim të plotë të kontratës.

SISTEMI I FATURIMIT

I. Moduli i Faturimit dhe Pagesave

Moduli i Faturimit dhe Pagesave duhet të ofrojë funksionalitetet e mëposhtme:

1. Modul per krijimin e artikujve dhe planeve tarifore
2. Modul për regjistrin e abonentëve dhe profilin e abonentit
3. Modul per regjistrimin e matesave
4. Modul per hedhjen e leximeve
5. Modul per faturimin e abonentëve
6. Modul per arketimin e faturave te abonenteve
7. Integrim me sistemet e pagesave qe vijne nga palet e treta
8. Raporte

1. Moduli per krijimin e artikujve dhe planeve tarifore

Artikujt përfshijnë shërbimet që sistemi u ofron abonentëve ose produktet fizike që përdoren nga SHRUKE, për qëllime të ndryshme. Plani tarifor përshkruan mënyrën se si do të tarifohen klientët që i përkasin një kategorie të caktuar. Kjo ndarje duhet bërë pasi një konsumator në kategorinë “Familje” mund t’i ofrohen artikuj të ndryshëm me një klient në kategorinë “Institucion”. Një plan tarifor diferencohet nga artikujt që do të përfshijë, pra janë pikërisht artikujt dhe të dhënat për çmimet, sasinë, frekuencën e tarifimit, që përcaktojnë një plan tarifor. Sistemi duhet të mirembahet që të mundesoje krijimin e planeve tarifore nga nderfaqja në mënyrë të lehtë për përdoruesit. Për planet e tarifimit duhet të jete mundësia e përcaktimit të frekuencës së tarifimit.

2. Modul për regjistrin e abonentëve dhe profilin e abonentit

Moduli i Faturimit dhe Arketimit duhet të jete funksional që të përfshijë funksionet për krijimin dhe regjistrimin e abonentëve. Për çdo abonent ekzistues ose të ri sistemi duhet të jete funksional me minimalisht këto fusha:

- Emri i klientit
- Nr. Dokumentit – bëhet fjalë për numrin e ID-së së klientit.
- Datë/Nr. kontrate
- Nr. Familjarëve – përkon me numrin e pjestarëve në rastin e një familjeje.
- Kategoria e Konsumatorit,
- Adresa
- Vendodhja në hartë
- Plani tarifor
- NIPT – në rastin e bizneseve ose institucione publike
- Të dhënat e matësive të klientit
- Statuset e klientit - aktiv, pasiv, prerje, njoftim debitori etj.

3. Modul për regjistrimin e matësive

Matësit përfaqësojnë pajisjet teknike që vendosen në ambientet e konsumatorëve dhe bëjnë matjen e sasisë së konsumuar të një artikulli, dhe në rastin aktual të ujit të pijshëm. Një matës mund të krijohet gjatë çeljes së një klienti të ri ose mund të krijohet dhe një mënyrë të pavarur, dhe të caktohet më pas një klienti. Informacioni që duhet të plotësohet për matësin e ri duhet të përmbajë:

- Numri i matësit - numër unik për identifikimin dhe referimin e matësit në sistem.
- Fillimi i numërimit - përcakton vlerën fillestare të matësit në momentin që do të vendoset te një klient.
- Tipi i matësit,
- Data e plumbosjes dhe Data e prodhimit i referohet datës kur është prodhuar dhe plumbosur aparati matës.
- Lloji i matësit
- Diametri

Ne cdo moment SHRUIKE duhet te kete mundesi te shikojte raporte mbi matesat e regjistruar, matesat e instaluar, nderrimet e matesave etj.

4. Modul per hedhjen e leximeve

Ne kete modul duhet te menaxhohet printimi i listave per leximin e abonenteve, hedhja e leximeve nga operatorët, kryerja e kontroleve perpara se te behet mbyllja e periudhes se faturimit.

5. Modul per faturimin e abonentëve

Ne modulën e faturave duhet te jepet informacion per periudhat e faturimit. Periudha e faturimit përfshin një periudhë kohore të caktuar, zakonisht një mujore, brenda të cilës do të agregohen të dhënat mbi konsumin e artikujve të ndryshëm nga klientët brenda kësaj periudhe, me rezultat final gjenerimin e faturave për ta. Ketu duhet te jepet informacion per numrin e abonenteve te faturuar vleren e faturimit etj.

6. Modul per arketimin e faturave te abonenteve

Moduli i arkës është një nga pikat kryesore të sistemit të faturimit. Në këtë modul duhet te menaxhohen të gjitha arketimet e realizuara nga abonentët nepermjet arkave, bankave ose paleve te treta te tjera, krijimi i mandative te arkëtimit, krijimi i njesive te reja te arkave ose bankave etj.

Per cdo veprim arke duhet te ruhet operatori i cili realizon arketimin, data dhe ora e sakte e veprimit.

Sistemi duhet te jete funksional ne mundesine e regjistrimit dhe likuidimit te plote edhe te pjesshem te faturave.

7. Raportet

Sistemi duhet te jete funksional me raporte te cilat japin informacion mbi:

- Faturimin sipas zonave
- Faturimin sipas klasave te sherbimit
- Faturimin sipas kategorive te klienteve
- Mbi debine e detajuar te abonenteve
- Debine sipas Kategorise se kliente
- Debine sipas klasave te sherbimit
- Raporte mbi konsumin
- Raporte krahasuese mbi faturimin ne periudha te ndryshme kohore
- Raporte per matest e vendosur ne periudhe kohore
- Raporte te detajuara per arketimin
- Etj

Raportet duhet te eksportohen ne pdf dhe ne excel.

II. Moduli i manaxhimit te perdoruesve

Sistemi duhet të jetë funksional me module të qenderzuar për menaxhimin e përdoruesve në sistem duke mundësuar menaxhimin e roleve, të drejtave të tyre në sistem, përdoruesve, përcaktimin e tyre nëpër role, etj.

III. Moduli i konfigurimeve

Sistemi duhet të jetë funksional me modulën e qenderzuar ku të jetë mundësia të konfigurohen parametrat për të gjithë modulet duke përfshirë faturimin e arketimit, sigurinë e sistemit, të dhëna për ndërmarrjen, etj.

Të jetë mundësia që të konfigurohet politika e fortesisë, gjatësisë, skadencës e password në sistem.

IV. Integrimi

Sistemi të përbehet nga module të cilat janë të integruara mes tyre që ndajnë të njëjtin modul të drejtë përdoruesish dhe sigurie, modul raportimi, modul konfigurimi parametrash, etj. Sistemi duhet të jetë i integruar me kanalet e pagesave elektronike të cilat janë sisteme informatike të paleve të treta që komunikojnë nëpërmjet web shërbimeve të vecanta për secilën palë. Modulet duhet të jenë të integruar mes tyre ku moduli i faturimit të jetë i integruar me modulën e fiskalizimit për fiskalizimin e të gjithë faturave të abonenteve në dhe nga sistemi i faturimit.

V. Afati i implementimit

Sistemi i përbërë nga moduli i Faturimit dhe Arketimit, moduli i Fiskalizimit duhet të përmiresohet dhe të jenë të përdorshme nga Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Elbasan brenda 30 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës si dhe të mirëmbahet për 12 muaj.

VI. Manualet

Sistemi duhet të shoqërohet me manualët perkatese në gjuhën shqipe për çdo ndryshim të kryer në të.

VII. Kërkesa të përgjithshme

- Sistemi duhet të mirëmbahet në Infrastrukturen e SHRUKË.
- Sistemi është web based, pra çdo përdorues duhet të ketë mundësinë ta përdorë atë nga web-i.
- Sistemi i ofertuar duhet të jetë COTS (Commercial off the Shelf Software).
- Çmimi i mirëmbajtjes së sistemit të ofruar nuk duhet të ketë varësi nga numri i përdoruesve.
- Çmimi i mirëmbajtjes së sistemit të ofruar nuk duhet të ketë varësi nga krijimi i ambientit test.
- Të gjithë modulet duhet të jenë të integruar me njëri-tjetrin dhe të qëndrojnë mbi një platformë të përbashkët. Zgjidhjet e bazuara mbi integrimin e moduleve të ndërtuara mbi teknologji të ndryshme, apo module të gatshme me origjinë të ndryshme, nuk pranohen pa miratimin e shoqërisë SHRUKË.

- Funksionalitetet e sistemit duhet të arrihen me parametrizime dhe konfigurime. Parametrizimet dhe konfigurimet, duhet të jenë të mundura të realizohen nga ndërfaqja e përdoruesit administrator të sistemit ose me ndryshime në parametra dhe jo direkt në databazë. Ndryshimet në kode behen vetëm me miratim të shoqërisë shruke.
- Sistemi duhet të ruajë të dhënat në një bazë të dhënash relacionale, pa licence ose me licensat egzistuese dhe pa kufizim në numër përdoruesish në nivel aplikimi, volum të dhënash apo kufizime të tjera.
- Aplikacioni duhet të mundësojë export masiv të dhënash në bazë dokumentash.
- Aplikacioni duhet të mundësojë export mujor të dhënash (faturat) në formatin json file, të pershtatur sipas formatit të tatimeve, në mënyrë që mundësia e fiskalizimit të faturave të jetë e hapur për të kryer prej çdo operatori të licensuar për fiskalizim.
- Sistemi nuk duhet të jetë i izoluar për të mos lejuar zhvillime apo përshtatje të mëtejshme, por duhet të ofrojë API për të shtuar module të tjera në të ardhmen.

VIII. Moduli i gjurmëve (log) dhe sigurisë

- Sistemi duhet të ofrojë funksionalitete për monitorimin dhe auditimin e të gjithë veprimeve në sistem. Për çdo veprim duhet të ruhet data, autori (përdoruesi), rekordi i ndryshuar, fushat e ndryshuara për çdo rekord, vlerat para modifikimit dhe ajo pas modifikimit. Gjurmët e auditimit duhet të jenë të aksesueshme por të pamodifikueshme nga ndërfaqja e sistemit.
- Sistemi duhet të ofrojë të gjithë parametrat e sigurisë lidhur me autentikimin dhe kredencialet e llogarive, si vlefshmërinë dhe kompleksitetin e fjalëkalimeve të përdoruesve, skadimin e fjalëkalimeve, njoftim për afatin e skadimit etj.

IX. Moduli i fiskalizimit

Funksionalitetet që duhet të ketë programi:

- a) Të regjistrojë shpejt dhe lehtë dokumentacionin ku përfshihen faturat dhe arkëtimet.
- b) Të jetë i integruar me sistemin e faturimit që do të ofrohet. Faturat për të gjithë abonentët të merren automatikisht nga sistemi i faturimit dhe të fiskalizohen.
- c) Aplikacioni të mundësojë export mujor të dhënash (faturat) në formatin json file si dhe importim informacioni për fiskalizimin.
- d) Sistemi i fiskalizimit të dërgojë sistemit të faturimit të gjithë informacionin e nevojshëm mbi fiskalizimin e faturave.
- e) Faturat për veprimet të cilat nuk përfshihen në sistemin e billing si psh lidhje të reja, ndryshim emri etj. të ketë mundësi të regjistrohen në fature e më pas ato të jenë pjesë e dërgimit të informacionit për fiskalizim.
- f) Të gjenerojë raporte dhe informacion mbi faturat të cilat janë fiskalizuar ose jo.

Sipas vendimit nr:239 dt. 20/03/2020 bazuar në LIGJIN Nr. 87/2019 PËR FATURËN DHE SISTEMIN E MONITORIMIT TË QARKULLIMIT;

Operatori Ekonomik duhet të ketë zgjidhjen e certifikuar të software-it në formën e një aplikacioni individual, ose një sistemi kompjuterik të integruar, ose një aplikacion Cloud, i cili mundëson:

-
- a) krijimin e një fature, një fature shoqëruese dhe vendosjen e të gjithë elementeve të nevojshëm;
 - b) vlefshmërinë e operatorit që lëshon faturën ose faturën shoqëruese;
 - c) dërgimin e sigurt të të dhënave në sistemin qendror, duke përdorur certifikatën elektronike;
 - d) lëshimin dhe pranimin e faturave elektronike;
 - e) transmetimin automatik të të dhënave në administratën tatimore dhe marrjen e mesazhit
 - f) konfirmues nga administrata tatimore, pas verifikimit automatik të secilës faturë individuale ose fature shoqëruese;
 - g) ruajtjen e të dhënave të faturave ose të faturave shoqëruese;
 - h) gjenerimin e numrit të sigurisë së lëshuesit të faturës (NSLF) dhe numrit të sigurisë së lëshuesit të faturës shoqëruese (NSLFSH);
 - i) gjenerimin e kodit QR;
 - j) printimin e faturës ose thjesht kodit QR, në situata të përcaktuara në ligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”;
 - k) sigurojnë shkëmbimin e të dhënave në kohë reale dhe me autentifikim të sigurt të pajisjeve fiskale ekzistuese ose sistemit të fiskalizimit;

sipas LIGJ Nr. 2/2017 PËR SIGURINË KIBERNETIKE

Funksionalitetet të tjera që duhet të ketë programi:

1. Bazat e të dhënave, të jenë të pa-aksesueshme jashtë këtij sistemi
2. Hyrja në program të sigurohet me kredenciale “Përdorues” dhe “Fjalëkalim”.
3. Të ofrojnë një mekanizëm për administrimin e privilegjeve në mënyrë të detajuar për funksionalitete të ndryshme. Në këtë mënyrë çdo përdorues ka akses vetëm tek ambientet, modulet apo raportet që i janë përcaktuar më parë nga një përdorues administrator.
4. Të ofrojnë mundësinë për të përcaktuar autorizime të detajuara se cili përdorues apo rol të mund të shikojë, administrojë llogari apo element ose ambiente të caktuara.
5. Të ofrojnë mundësinë që një përdorues i caktuar të mund të shikojë vetëm veprimet e tij dhe jo veprimet e të tjerëve.
6. Të mundësojë regjistrimin e çdo krijimi, anulimi apo modifikimi dokumenti nga ana e përdoruesve.
7. Të mundësojë regjistrimin e datës, orës, përdoruesit dhe të IP-së së atij që ka kryer veprimin gjatë regjistrimit të auditimit.
8. Të mundësojë historikun e veprimeve, pra të mund të shihen dokumentet si kanë qenë para modifikimit.
9. Backup. Të dhënat të ruhen çdo ditë nëpërmjet një procesi automatik backup në dy vende fizike të pavarura nga databasa kryesore e të dhënave.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Objekti : Shërbimet që kërkohen: "Permiresime dhe mirembajtje per sistemin e faturimit dhe fiskalizimi i faturave".

NR	EMËRTIMI	Njesia	SASIA	Vlera (pa TVSH)	Afati i fillimit te sherbimit nga nenshkrimi i kontrates
1	Mirembajtje dhe permiresime per sistemin e faturimit dhe fiskalizimi i faturave	Muaj	12		10 dite
	VLERA (lekë)				
	TVSH (20%)				
	TOTALI ME TVSH (lekë)				

- Afati i kontratës është 12 muaj duke nisur nga data e nenshkrimit te kontrates.

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sha, e krijuar më 1 janar 2023, ka në përbërje të saj njësitë: Elbasan, Gramsh, Peqin, Belsh, Librazhd dhe Cërrik. Në të gjitha këto njësi bëhen pagesat e faturave të ujit të pijshëm, fatura të cilat mbështetur në udhëzimin "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", Neni 2 "Fusha e veprimit", pika "1. Sipas nenit 2 të ligjit, dispozitat e këtij udhëzimi zbatohen nga të gjithë tatimpaguesit që lëshojnë fatura në përputhje me Ligjin "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit" dhe Ligjin "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar" dhe përcakton detyrimet për lëshimin e faturës dhe zbatimin e procedurës së fiskalizimit në kohë dhe detyrimeve të tjera.", janë pjesë e sistemit të fiskalizimit të tyre.

Numri i arkave të shoqërisë, që përdorin zgjidhjen me fiskalizim, janë si më poshtë:

Njësia Elbasan 1 (një)
Njësia Gramsh 1 (një)
Njësia Peqin 1 (një)
Njësia Belsh 1 (një)
Njësia Librazhd 1 (një)
Njësia Cërrik 1 (një).

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Detyrat: Mirembajtje dhe permiresime per sistemin e faturimit dhe fiskalizimi i faturave ne SHRUKË

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sha.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit

Operatori duhet të ketë të përfshirë në objektin e veprimtarisë në Ekstraktin e QKB edhe objektin e prokurimit të kësaj kontrate.

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetë-deklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare nga data e zhvillimit të tenderit ku vlera e xhiros minimale vjetore për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2. Pasqyrat financiare për 3 (tre) vitet e fundit financiare nga data e zhvillimit të tenderit të konfirmuara nga administrata tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05. 03. 2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në bilancet e kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19. 05. 2008 *“Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet/shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlogaritur të fondit limit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të leshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shenohen vlera, afati i perfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shenohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,

për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shenohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me çertifikatë sipas standartit të sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 ose ekuivalent të vlefshme.

Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me çertifikate ISO 27001 (për Sigurinë e Informacionit) ose ekuivalent te vlefshme.

Fusha e certifikimit duhet te perkoje saktesisht me objektin e ketij prokurimi.

- 2.3.3 Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar te pakten 4 (kater) punonjes te diplomuar ne fushen e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike etj ne fushen e IT). Plotesimi i ketij kriteri duhet te vertetohet me paraqitjen e formulareve E-SIG per periudhen e 3 muajve te fundit duke iu referuar dates se hapjes se ofertave dhe diplomave te shkollimit te larte universitar per secilin prej punonjesve.
- 2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (nje) punonjës të certifikuar për administrator sisteme baze të dhënash (database). Kjo te vertetohet nepermjet paraqitjes se Certifikates. Në rast se certifikatat janë në gjuhë të huaj (te ndryshme nga ato te percaktuara ne DT) operatori ekonomik duhet ti paraqesë të përkthyer sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- 2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 3 (tre) punonjës të certifikuar për zhvillim në teknologji web. Kjo te vertetohet nepermjet paraqitjes se Certifikates. Në rast se certifikatat janë në gjuhë të huaj (te ndryshme nga ato te percaktuara ne DT) operatori ekonomik duhet ti paraqesë të përkthyer sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- 2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të jetë i licensuar nga AKSHI dhe DPT për sistemin e fiskalizimit ose i autorizuar nga një prodhues i licensuar për shitjen e një produkti të licensuar të fiskalizimit.
- 2.3.7 Deklarate qe permbush specifikimet teknike te dhena ne shtojcen perkatese.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 10.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

• Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
